



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer 15-400-21921 i datës 29.04.2021, Vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer Nr.15-400/01-17272 të datës 31.03.2022 si dhe Listës përfundimtare të përfituesve të serave të publikuara nga Komisioni 1Nr.320-77083 të datës 20.12.2021, pas përfundimit të procedurave të ankesave, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM
PËR EKZEKUTIMIN E PAGESËS PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR
FERMERË

Neni 1

I. **OBLIGOHET**, Drejtoria për Buxhet dhe Financa të bëjë ekzekutimin e pagesës në shumë prej **330.160 €** (treqind e tridhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë euro) konform Vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer 15-400-21921 i datës 29.04.2021 dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer Nr.15-400/01-17272 të datës 31.03.2022 me qëllim të subvencionimit të fermerëve të komunës së Lipjanit me nga një serrë në sipërfaqe prej 50m².

II. Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2022, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti i dërgohet për zbatim Drejtoratit për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 400/01-21641
Lipjan, më 28.04.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

